



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

Nr. 17/1 Prot.

Tiranë, më 01.11.2019

V E N D I M

Nr. 11/1, datë 01.11.2019

Për miratimin e Rregullores “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Policisë Gjyqësore dhe caktimin e përbërjes dhe detyrave të Sekretariatit Teknik”.

Komisioni i Policisë Gjyqësore, i mbledhur sot në datën 01.11.2019, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe nenin 11, pika 6 të Ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”,

V E N D O S I

Miratimin e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Policisë Gjyqësore dhe caktimin e përbërjes dhe detyrat e Sekretariatit Teknik” të këtij Komisioni, në përputhje me tekstin bashkangjitur këtij vendimi.

K O M I S I O N I

~~KRYETARI~~
ALFRËD PROGONATI

ANËTAR

BLENDAR ÇELIKU

ANËTAR

HARI GOGO

ANËTAR

ERVIN BRAHAJ

ANËTAR

ERIND GJONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

Nr. 17 Prot.

Tiranë, më 01.11.2019

RREGULLORE

Nr. 11, Datë 01.11.2019

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË POLICISË GJYQËSORE SI DHE PËR PËRBËRJEN DHE CAKTIMIN E DETYRAVE TË SEKRETARIATIT TEKNIK TË KOMISIONIT.

Në mbështetje të nenit 11, pika 6 të Ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”,

KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

MIRATON KËTO RREGULLA:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i rregullores

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për organizimin, funksionimin dhe veprimtarinë e Komisionit të Policisë Gjyqësore (në vijim Komisioni) si dhe për përbërjen dhe përcaktimin e detyrave që do të kryej Sekretariati Teknik i Komisionit të Policisë Gjyqësore.

Komisioni është organ kolegjal dhe ka pavarësi në vendimarrjet e tij për kryerjen e funksioneve, duke respektuar detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi.

Neni 2

Qendra dhe stema e Komisionit

1. Komisioni ka vendodhjen në Zyrat e Prokurorisë së Përgjithshme.
2. Mbledhjet e Komisionit zhvillohen në ambientet e Prokurorisë së Përgjithshme.
3. Komisioni operon me stemën e Prokurorisë së Përgjithshme duk shtuar në të emërtesën Komisioni i Policisë Gjyqësore
4. Aktet e prodhuara nga Komisioni vulosen me vulën e Prokurorisë së Përgjithshme.
5. Për operativitetin e përditshëm dhe rregullshmërinë e administrimit të dokumentave, Komisioni përdor protokoll të brendshëm dhe vulë të brendshme e cila nuk ka efekt në mardhëniet me të tretët.

Neni 3

Caktimi i anëtarëve dhe kryetarit të Komisionit

Mënyra e caktimit të anëtarëve dhe kryetarit të Komisionit përcaktohet sipas nenit 9 të Ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.”

Neni 4

Detyrat e kryetarit të komisionit

Në përputhje me kërkesat e ligjit për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore, kryetari i komisionit ka këto detyra:

- a. Thërret mbledhjen e komisionit, vendos për datën dhe orën dhe përcakton rendin e ditës e pikat e tij.
- b. Kryeson mbledhjet e komisionit
- c. Udhëzon Sekretariatit Teknik për përgatitjen e mbledhjes së komisionit, përgatitjen e materialeve që do të shqyrtohen dhe sigurohet që ato t’u shpërndahen anëtarëve të komisionit.
- ç. Mban kontaktet me anëtarët e komisionit dhe përfaqëson komisionin në marrëdhënie me të tretët në përputhje me ligjin 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore “.
- d. Me autorizim të Komisionit, nënshkruan marrëveshje dhe memorandume me institucione të tjera.
- e. Kryen cdo detyrë tjetër të parashikuar në këtë ligj dhe rregullore të komisionit.

Neni 5

Komunikimi me anëtarët e komisionit

Kryetari ka për detyrë të informojë zyrtarisht anëtarët për :

- a. Propozimin e axhendës së rradhës.
- b. Procesverbalet e mbledhjes
- c. Cdo rast tjetër në përputhje me ligjin për policinë gjyqësore ose me rregulloren e posacme të miratuar nga komisioni.

Neni 6

Përgjegjësitë e anëtarëve

1. Anëtarët e Komisionit marrin pjesë në punën e komisionit në kushte të barabarta.
2. Anëtarët janë të detyruar :
 - a. Të marrin pjesë në mbledhjen e Komisionit
 - b. Të marrin pjesë në punën e grupeve të punës të ngritura nga Komisioni
 - c. Të kryejnë veprimtari të caktuara nga Komisioni brenda kompetencave dhe përgjegjësi të Komisionit.
 - d. Të njoftojë Sekretariatit Teknik kur nuk mund të marrë pjesë në mbledhjen e komisionit duke dhënë dhe justifikim për këtë.
 - e. Të shmang paragjykimin ose diskriminimin mbi cdo lloj baze gjatë vendimmarrjes.

Neni 7

Rregjistri i anëtarëve të komisionit

Sekretariati teknik mban një rregjistër për anëtarët e Komisionit dhe mandatet e tyre . Rregjistri përmban të gjitha të dhënat për datën e caktimit dhe mbarimit të mandatit ,si dhe emrin e institucionit që i ka caktuar.

Neni 8

Konflikti i interesit

1. Anëtarët e komisionit nuk marrin pjesë në diskutim dhe as nuk votojnë për një çështje në rast papajtueshmërie ambientale, etike dhe konflikti i interesit ose ndonjë pengesë tjetër ligjore sipas parashikimeve të ligjit për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore.
2. Në fillim të mbledhjes, pas miratimit të rendit të ditës, kryetari i Komisionit kërkon nga anëtarët e pranishëm në mbledhje që të deklarojnë ekzistencën e ndonjë konflikti i interesit ose ndonjë pengesë ligjore për vete ose për ndonjë anëtar tjetër lidhur me ndonjë çështje të rendit të ditës.
3. Anëtari i komisionit deklaron arsyen e përjashtimit duke specifikuar natyrën e interesit ose të pengesës.
4. Vendimi për heqjen dorë merret verbalisht nga kryetari pasi merr mendimin e

anëtarëve të pranishëm dhe kjo pasqyrohet në procesverbal.

5. Në rastet kur për shkak të papajtueshmërisë ose konfliktit të interesit të anëtarit të Komisionit, nuk arrihet kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes Kryetari i Komisionit u kërkon institucioneve të emërtesës zëvendësimin e tij sipas kriterëve të parashikuarnë nën 9, pika 1 e ligjit për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.
6. Në rastet kur për shkak të papajtueshmërisë, konfliktit të interesit dhe heqjes dorë të anëtarit të Komisionit, nuk arrihet kuorumi i nevojshëm për diskutimin e një ose disa pikave të rendit të ditës, diskutimi i tyre shtyhet për mbledhjen e radhës.

Neni 9

Kompetencat e komisionit

Komisioni ushtron kompetencat e mëposhtme:

1. Përcakton numrin e përgjithshëm të oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve dhe shërbimeve, në bashkëpunim me Prokurorin e Përgjithshëm dhe ministrat përgjegjës të cilët kanë në varësi shërbimet e policisë gjyqësore.
2. Emëron, ngrë në detyrë, transferon dhe komandon oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm.
3. Miraton transferimin dhe komandimin e oficerëve të Policisë Gjyqësore të shërbimeve, me propozim të titullarit të institucionit shtetëror ku ata bëjnë pjesë.
4. Shqyrton kërkesat për procedim disiplinor ndaj oficerëve të policisë gjyqësore sipas parashikimeve të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore"
5. Vlerëson rezultatet e punës dhe integritetin e oficerëve të policisë gjyqësore.
6. Përcakton rregullat për organizimin e trajtimit fillestar për hetimin sipas neneve 16 & 17 të ligjit të sipërpërmendur në bashkëpunim me Prokurorin e Përgjithshëm, Akademinë e Sigurisë ose institucionet publike arsimore të ngarkuara me ligj për trajnim profesional.
7. Vlerëson nevojat për trajnim dhe planifikon trajnimet e oficerëve dhe agjentëve të policisë gjyqësore në bashkëpunim me Prokurorinë e Përgjithshme dhe Akademinë e Sigurisë, dhe institucionet publike arsimore të ngarkuara me ligj për trajnim profesional.

Neni 10

Aktet e komisionit

Komisioni ushtron kompetencat e tij duke marrë vendime në mënyrë kolegjiale .
Vendimet duhet të përmbajnë bazën ligjore, arsyetimin e tij dhe kujt i drejtohen .

Neni 11

Mbledhjet e komisionit

1. Komisioni mbledhet sa herë të jetë e nevojshme për trajtimin e çështjeve që i shtrohen për zgjidhje, sipas kompetencave të parashikuara në ligjin nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.
2. Kryetari garanton respektimin e procedurës.

Neni 12

Kuorumi

Mbledhjet e komisionit janë të vlefshme kur në të janë të pranishëm të paktën tre anëtarë të tij.

Neni 13

Rendi i ditës

1. Rendi i ditës për mbledhjet e komisionit bëhet nga kryetari i Komisionit duke marrë parasysh rastet dhe nevojat e Komisionit, për t’iu përmbajtur afateve kohore, procedurave dhe detyrimeve të tjera ligjore, si dhe detyrat e tjera të përcaktuara përmes vendimmarrjes përkatëse në mbledhjet e mëparshme të komisionit.
2. Pikat e rendit të ditës renditen sipas rëndësisë së tyre.
3. Rendi i ditës duhet të përfshijë të paktën të dhënat e mëposhtme :
 - a. Procesverbalin e mbledhjes së mëparshme të Komisionit
 - b. Të gjitha pikat e propozuara nga kryetari për t’u shqyrtuar në mbledhjen e komisionit
 - c. Informacion shtesë lidhur me pikat e rendit të ditës.

Neni 14

Zhvillimi i mbledhjes

1. Pas hapjes të mbledhjes kryetari deklaron se kuorumi i kërkuar është i pranishëm . Kur ndonjë prej anëtarëve largohet nga mbledhja atëherë kryetari deklaron nëse ka kuorum për vazhdimin e mbledhjes.
2. Pas hapjes së mbledhjes kryetari paraqet rendin e ditës. Pas miratimit të rendit të ditës komisioni miraton procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

3. Si rregull, diskutimi i cdo pike të përfshirë në rendin e ditës hapet me një paraqitje nga ana e kryetarit ose relatorit në emër të komisionit, dhe përfundohet me votimin e propozimit.
4. Pas diskutimeve lidhur me pikat e rendit të ditës, kryetari garanton menaxhimin e kohës së diskutimeve dhe mund të caktojë afate kohore për diskutime gjatë takimit.
5. Pa parajgykuar të drejtën për të shprehur mendimin për deklarin e votës, asnjë anëtar nuk mund të flasë më shumë se një herë gjatë të njëjtit diskutim, përvece kur bëhet fjalë për një pyetje të rastit ose çështje personale.

Neni 15

Votimi

1. Vendimet e Komisionit merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve.
2. Votimet realizohen me anë të ngritjes së dorës.
3. Sekretariati teknik mban shënim mënyrën e votimit dhe arsyetimin e votës së secilit anëtar.
4. Kryetari është anëtar i fundit që voton për secilën çështje, dhe në rast barazimi të votave ,votimi i tij është votë vendimtare.

Neni 16

Vendimet

Vendimet e komisionit përbëjnë akt administrativ dhe nënshkruhet nga secili anëtar që merr pjesë në mbledhje. Refuzimi i një anëtar i për të nënshkruar përmbajtjen e një vendimi nuk përbën shkak për pavlefshëminë e aktit. Aktet e tjera të prodhuara nga komisioni dhe që nuk kanë karakterin e një akti administrativ individual, nënshkruhen nga kryetari i Komisionit.

Neni 17

Procesverbalet e mbledhjes

Për cdo mbledhje të komisionit mbahet procesverbal me një përmbledhje të diskutimeve.

1. Procesverbali i mbledhjes dhe përmbledhja e diskutimeve përmban të paktën vendin , datën dhe orën e mbledhjes, numrin e anëtarëve të pranishëm , emrat e tyre , konkluzioni lidhur me kuorumin , përjashtimin e anëtarëve dhe arsyetimin përkatës , rendin e ditës së mbledhjes , përmbajtje të shkurtër për cdo pikë të rendit të ditës, anëtarët e pranishëm në diskutimin e secilës pikë, rezultatin e votimit, mënyrën e

votimit të cdo anëtari dhe mendimet në pakicë të anëtarëve lidhur me vendimet, arsyet për shtyrjen e mbledhjes, mbylljen e mbledhjes dhe vendimet .

2. Procesverbali i mbledhjes me përmbledhjen e diskutimeve nënshkruhet nga kryetari dhe punonjësja e sekretariatit teknik që mban procesverbalin .

Neni 18

Komunikimi me publikun dhe mediat

Pas cdo mbledhje komisioni komunikon me publikun nëpërmjet një njoftimi për shtyp të përgatitur sipas udhëzimeve të kryetarit dhe që publikohen në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme, e cila, jep shkurtimisht informacionet mbi çështjet e shqyrtuara në rendin e ditës dhe thelbin e vendimmarrjes.

Neni 19

Administrata e komisionit

Komisioni ka Sekretariatit Teknik i cili vepron si administrat në mbështetje të kryetarit të komisionit për zbatimin e detyrave të Komisionit.

Sekretariati teknik drejtohet nga kryetari i Komisionit.

Neni 20

Organizimi i Sekretariatit teknik

1. Sekretariati teknik i Komisionit përbëhet nga punonjës nga rradhët e personelit administrativ të Prokurorisë së Përgjithshme të caktuar sipas marveshjes së kryetarit të Komisionit me Prokurorin e Përgjithshëm.

2. Sekretariati teknik përbëhet nga punonjësi Specialist i Burimeve Njerëzore dhe punonjësi i Protokoll- Arshivës.

Punonjwsi Specialist i Burimeve Njerëzore ka për detyrë :

- a. Rregjistrimin dhe administrimin e kërkesave dhe propozimeve të ardhura nga institucionet përkatëse për emërim, transferim, komandim dhe procedimin disiplinor të oficerëve të policisë gjyqësore.
- b. Përgatit materialet dhe dosjet për çështjet që do trajtohen në mbledhjet e Komisionit.
- c. Mban rregjistrin në të cilin pasqyrohen të gjitha lëvizjet e oficerit të Policisë Gjyqësore me vendim të Komisionit.
- d. Kryen detyra të tjera të caktuara me ligj, akt nënligjor apo urdhër të kryetarit të Komisionit.
- e. Specialisti i burimeve njerëzore ushtron dhe detyrat e kordinatorit për të drejtën e informimit në përputhje me ligjin nr 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”.

Punonjësi Specialist i Protokoll- Arshivës ka për detyrë :

- a. Merr në dorëzim kundrejt firmës postën hyrëse të Komisionit.
 - b. Rregjistron , protokollon në rregjistrin e korrespondencës, korrespondencën hyrëse dhe dalëse të Komisionit. Për shkresat dalëse kontrollon kushtet e normave tekniko-profesionale dhe njofton kryetarin.
 - c. Merr masat për dorëzimin e korrespondencës tek kryetari i komisionit brenda ditës.
 - d. Administron tërësinë e dokumentave të krijuara dhe të ardhura në komision.
 - e. Kryen detyra të tjera të caktuara me ligj, akt nënligjor apo urdhër të kryetarit të komisionit.
3. Në varësi të ngarkesës dhe numrit të çështjeve që i vijnë Komisionit, numri i punonjësve të Sekretariatit teknik, me marveshje të Kryetarit të Komisionit dhe Prokurorit të Përgjithshëm, mund të shtohet me punonjës të tjerë të stafit administrativ të Prokurorisë së Përgjithshme.

Neni 21

Dispozitat e përkohshme

Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj rregulloreje bëhet nëse shumica e thjeshtë e antërëve voton në favor të atyre ndryshimeve.

Për të bërë një ndryshim të tillë propozuesi duhet ta paraqesë atë prapakisht tek kryetari i komisionit .

Neni 22

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Komisioni i Policisë Gjyqësore .

KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORË

**KRYETARI
ALFRED PROGONATI**

**ANËTAR
BLEDAR ÇELIKU**

**ANËTAR
HARI GOGO**

**ANËTAR
ERVIN BRAHAI**

**ANËTAR
ERIND GJONI**